



P Z A P  
I P Ž P

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.213/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Skender Çuçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të pjesëmarrjes së fëmijëve në fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 29.01.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Anr.213/2025 e datës 27.01.2025, ashtu që subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të pjesëmarrjes së fëmijëve në fushatë zgjedhore, i shqiptohet dënim i më gjobë në lartësi prej 2000 (dymijë) euro.

II. Detyrohet Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), që gjobën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datën 27.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ku pretendohet se kandidatja për deputete, aktualisht Ministre në Ministrin e Drejtësisë nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, në të cilën theksohet se më datën 26.01.2025, në rrjetin social profilin e saj në facebook ka publikuar një fotograf të tubimit të mbajtur në shkollën "Gjergj Fishta" në Prishtinë, ku shihet një fëmijët i moshës së mitur nën 15 vjeç, në këtë mënyrë Albulena Haxhiu, në cilësi të Ministres në Ministrin e Drejtësisë dhe si kandidate për deputete e LVV-së, në këtë tubim ka keqpërdorur fëmijët e mitur, sidomos ata të moshës nën 15 vjeçare, duke e ditur se veprimet e tillë janë të ndaluar, të cilat janë të përcaktuara me nenin 5, par.3 të Ligjit NR. 07/2024 Për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar. Më tutje në ankesë pretendohet se kandidatja që ka bërë publikimin e fotografive është me profesion juriste, ministre aktuale në Ministrin e Drejtësisë dhe se e njëjta ka qenë në dijeni të plot që këto veprime janë rreptësishtë të ndaluar dhe se veprimet e tillë përbëjnë shkelje të drejtave elementare të

fëmijëve, të cilat janë të përcaktuara me të drejtat dhe Konventat Evropiane dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Po ashtu theksojnë se ky postim është ende aktiv në profilin e kandidates në fjalë.

Si provë ka bashkangjitur fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë që dëshmon prezencën e fëmijëve ne tubimin në fjalë dhe Skreenhoot i postimit nga Albulena Haxhiu, e publikuar më datë 26 janar 2025, ne ora 21: 22/h, ftes për tubimin e Lëvizjes Vetëvendosje ne komunën e Prishtinës, SHFMU “Gjergj Fishta” për datën 26 janar ne orën 18, e publikuar ne rrjetin social Facebook.

Kërkojmë nga PZAP-i, që në rast se gjejnë shkelje në këto veprime, të shqiptoj sanksionin e merituar sipas legjislacionit në fuqi.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosje, i kundërshton si të paqëndrueshme pretendimet e palës ankuese, edhe atë për shkak se sa i përket pretendimit të palës ankuese te subjektit politik të PDK-së, ankesa nuk përmban asnjë fakt i cili do të munde te konsiderohej si shkelje e nenit 5, paragrafi 3 te Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, dhe se një fakt i tillë është i pa qëndrueshëm dhe është jashtë standardeve te tilla te kërkua me këtë nene Ku sipas nenit 5, paragrafi 3 i Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës se Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar shprehimisht thotë se “ Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund te angazhoje person nën moshën pesëmbëdhjetë 15 vjeç në fushatën zgjedhore. Pjesëmarrja e Fëmijëve ne fushatën zgjedhore, nuk mund të behet pa prezencën apo pëlqimin e prindërve.”

Me tutje ne përgjigje ne ankesë theksojnë se siç vërehet edhe nga provat e bashkangjitura të pretenduesit të PDK-së, për angazhimin e fëmijëve në fushat shprehimisht pretendimit se “ ... vërehet prania e një fëmije të mitur, nen moshën 15 vjeçare, pa prezencën dhe rrjedhimisht pa pëlqimin e prindërve”, aspak nuk ka të bëjë me shkeljet e tilla dhe se parashtruesi i ankesës në asnjë moment nuk e argumenton këtë. Në vazhdim theksohet se siç vërehet edhe nga fotografit e ngjarjes se fëmija nuk munde të identifikohet bazuar në fotografi dhe prova të ofruara, i njëjtë po ashtu është në prezencën e prindërve, ashtu siç është normuar edhe në dispozitat e nenit 5 paragrafi 3 i Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi pretendimet ankimore gjeti se:

### Ankesa është e bazuar

Paneli ka gjetur se nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë ka konstatuar se në tubimin e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje(LVV), për fushatë zgjedhore në shkollën “Gjergj Fishta” në Prishtinë, kanë marrë pjesë edhe fëmijët, veprime këto qe bien në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenin 5, par.3 të Rregullores Zgjedhore nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, me të cilën përcaktohet se "Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhojë persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatë zgjedhore".

Paneli, me rastin e vendosjes i shqyrtoi pretendimet e subjektit politik LVV, se fëmijët kane qene ne shoqërinë e prindërve te tyre, një pretendim mbetet në suaza te supozimit sepse nga fotot e prezantuara si prove nuk vërehet se afér fëmijëve është ndonjë person madhor, ndërsa

në kuadër të pretendimeve tjera të theksuara në përgjigje në ankesë, te njëjtat ishin te pabazuara nga se nuk është kontestuese nga fotot e ofruara si dëshmi nga subjekti politik PDK shihet se në rrjetin social facebook të ministres aktuale te Drejtësisë dhe kandidates për deputete nga radhët e subjektit politik LVV, fotografia me pjesëmarrjen e fëmijëve, njëherit ky postim është shfaqur gjatë fushatës zgjedhore përfitimit te votave dhe përmban numrin identifikues 118 të këtij subjekti me të cilin numër garon për Zgjedhet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

Andaj paneli vlerëson se veprimet tilla janë në kundërshtim me dispozitat ligjore te LZP.

Paneli me rastin e vëndosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrëthanat si në vijim: se përfshirja e fëmijëve ne fushata zgjedhore përbenë shkelje te te drejtave te tyre dhe se nuk është ne interesin me te mire te tyre po ashtu paneli ka vlerësuar natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, subjektit politik LVV, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës

Kështu qe duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “*vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të bazuara, përfaktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi të bazuar.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim nenit 118 paragrafi 1, dhe nenit 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë  
Anr.213/2025 datë 29.01.2025



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.